



**KOMUNA
DRENAS**

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



Drenas

Pilot projekti për mbeturina në Komoran dhe Tërstenik

Bazuar në Ligjin për Mbeturinat që është miratuar në vitin 2012 dhe në Rregulloren Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave, prodhuesit e mbeturinave janë të obliguar që të jenë pjesë e sistemit dhe shërbimit të mbledhjes së mbeturinave, të cilat janë nën përgjegjësinë e komunës. Kjo po ashtu është në përputhje me Direktivën e Kornizës për Mbeturinat e vitit 2008 të Bashkimit Evropian.

Zbatimi i suksesshëm i ligjit dhe vënia në zbatim e një sistemi funksional për mbeturinat janë shumë të rëndësishme për Kosovën. Vetëm kur të sigurohet se mbeturinat trajtohen dhe hidhen si duhet atëherë mund të pakësohet rreziku ndaj shëndetit dhe të krijohet një mjedis më i pastër për të gjithë.

Prandaj, ne (komuna e Drenasit) e kemi hartuar një koncept të Menaxhimit të Mbeturinave, në të cilin janë paraqitur hapat e nevojshëm për zbatimin e ligjit dhe të rregullores. Me këtë koncept parashihet që shërbime të mbledhjes së mbeturinave t'i ofrohen çdo amvisërie dhe çdo biznesi.

Megjithatë, vënia në zbatim e një sistemi të mbledhjes së mbeturinave, për tërë komunën e Drenasit nënkupton një qasje hap pas hapi, e cila duhet të testohet në pilot zona. Prandaj, ne i kemi zgjedhur Tërstenikun dhe Komoranin për të shërbyer si pilot zona. Këto aktivitete janë paraparë të zhvillohen për vitin 2013.

Gjatë takimeve me qytetarë, administratorë të fshatrave, studentë dhe biznese në Drenas, shumica janë pajtuar që ta mbështesin këtë projekt.

Ne llogarisim në mbështetjen tuaj për ta krijuar një Drenas më të pastër dhe më të shëndetshëm!

Faleminderit për përkushtimin tuaj dhe ju lutem gjeni të bashkëngjitur më poshtë buletin për më tepër informata.

Me respekt,

Komuna e Drenasit.

Të dhëna të rëndësishme për sistemin e mbeturinave dhe përdorimin e kontejnerëve të rinj:

Fushata e Pastrimit

- Para se sistemi i ri të vihet në zbatim (Tërstenik dhe Komoran), është e domosdoshme që në këto pilot zona të bëhet pastrimi i mbeturinave dhe deponive ilegale. Fushata e pastrimit, do të fillojë më 24 maj dhe çdo qytetar inkurajohet që të marrë pjesë dhe të kontribuojë për një mjedis më të pastër.
- Qytetarët mund t'i marrin thasët e mbeturinave nga pikat e shpërndarjes në Tërstenik dhe Komoran, por edhe vullnetarët do të jenë të gatshëm të ofrojnë thasët dhe dorezat për pastrim.
- Thasët e mbushur plot grumbullohen në një pikë të caktuar brenda lagjeve dhe më pas kompania "Pastrimi" do t'i grumbullojë dhe t'i transportoj në vendin e duhur.

Shpërndarja dhe përdorimi i kontejnerëve

- Komuna, së bashku me GIZ-në, kanë mbështetur financiarisht blerjen e kontejnerëve të rinj për Tërstenik dhe Komoran.
- Çdo amvisëri, biznes apo shkollë mund të pajiset me një kontejner të ri. Shpërndarja do të fillojë më 24 maj 2013 dhe të vazhdojë deri në fillim të qershorit.
- Për amvisëri, kontejnerët do të zbrazen një herë në javë duke filluar nga qershori.
- Për biznese, kontejnerët do të zbrazen duke u bazuar në dispozitat e kontratës.
- Orarin e grumbullimit të mbeturinave e gjeni më poshtë.

Ju lutemi t'i përdorni kontejnerët e rinj me kujdes.

- Nuk guxon të hidhen në këta kontejnerë këto lloje të mbeturinave: hiri, mbeturinat nga kopshti, mbeturinave nga ndërtimet dhe mbeturinat e vëllimshme.
- Nëse dëshironi t'i largoni mbeturinat e veçanta që u përmendën më lart, ju lutemi kontaktoni me kompaninë Pastrimi, për ta caktuar kohën e mbledhjes së tyre.

Pyetjet dhe sugjerimet

Ne, me kënaqësi ju përgjigjemi pyetjeve tuaja! Po ashtu ju lutemi që të na dërgoni sugjerime për mënyrën e përmirësimit të shërbimeve tona. Prandaj, mos hezitoni të kontaktoni me ne për çdo çështje.

Numrat e telefonit: 038/585-140 ose 044/170-648. Nga e hëna deri të premten prej 8:00-16:00

ORARI I GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE (Amvisëri dhe Biznese):

E hënë	Tërstenik I
E martë	Komoran I
E mërkurë	Tërstenik II
E enjte	Komoran II

Çdo të premtë	Vetëm për biznese:Tërstenik dhe Komoran
---------------	---